

Imigracioni në Itali më 2014. Pikat kryesore përgatitur nga Qendra e Studimeve dhe Kërkimeve - IDOS

Në vitin 2015 migrantët në botë arritën të jenë, sipas disa vlerësimeve, të paktën 237 milionë, duke u shtuar veçanërisht në Europë e në Amerikën e Veriut. Mbi këto lëvizje vazhdojnë të ndikojnë pabarazitë e mëdha në botë: 48,0% e pasurisë së planetit mbahet nga 1,0% e popullsisë botërore, 46,5% nga një e pesta e popullsisë dhe pjesa tjetër 5,5% nga katër të pestat.

Pabarazitë ekonomike shoqërohen me kriza politike, ushtarake e mjedisore. Migrantët e detyruar kanë prekur më 2014 shifrën rekord prej 60 milionësh (8 milionë më tepër në një vit), prej të cilëve të ikur të brendshëm (dy të tretat e totalit), azilkërkues e refugjatë (përkatësisht 1,8 e 20 milionë). Veçanërisht azilkërkuesit gjejnë në rrugëtimin e tyre shumë pengesa, edhe në shkelje të hapur të dispozitave ndërkombëtare, siç vërteton ndërtimi ose projektimi i të paktën 65 mureve në vende të ndryshme.

Situata italiane dhe ajo europiane duhet të lexohen të lidhura me këto të dhëna globale. Në BE, në janar 2014, rezidentët e huaj ishin 33,9 milionë, baras me 6,7% të popullsisë së përgjithshme (20 milionë janë qytetarë të vendeve të treta e 14 milionë nga vende të tjera anëtare) e azilkërkuesit 626.710.

Italia është një nga vendet e mëdha të imigracionit, me 5.014.000 të huaj rezidentë në fund të vitit 2014 (rritje me 92.000 vetë kundrejt vitit të mëparshëm), ndërsa qytetarët italianë jashtë shtetit, që tani janë 150.000 më shumë, janë bërë gjithsej 4.637.000. Përqindja e imigrantëve mbi popullsinë (8,2%) vazhdon të jetë më e lartë se vlera mesatare europiane. Përveç kësaj, sipas vlerësimit të *Dossier* ka gjithsej 5.421.000 të huaj me dokumente të rregullta, duke përfshirë edhe jo komunitarët në pritje të regjistrimit në zyrën e gjendjes civile.

Të huajt rezidentë në Itali për më shumë se gjysma janë qytetarë të një vendi tjetër europian (më shumë se 2,6 milionë), nga të cilët më pak se 30% nga një vend i BE-së (1,5 milionë). Komuniteti më i madh në numër është ai rumun (1.131.839), i pasuar nga shqiptarët (490.483), marokenët (449.058), kinezët (265.820) e ukrainasit (226.060). Sipas vlerësimit të *Dossier*, të krishterët janë pothuajse 2 milionë e 700 mijë dhe myslimanët më shumë se 1 milion e 600 mijë (më pak në numër janë komunitetet e tjera fetare).

Më 2014 personat e kapur nga forcat e rendit në gjendje të parregullt nga ana e lejeqëndrimit kanë qenë 30.906 (të dhënat e Ministrisë së Brendshme) dhe 50,9% e tyre është riatdhesuar efektivisht (15.726). Mbërritjet nëpërmjet detit të atyre që largohen nga vendet e veta dhe migrantëve të tjerë kanë qenë 170.000. Kërkesat për azil kanë qenë 64.625 më 2014 e 30.535 në gjashtë muajt e parë të 2015. Në qershor 2015 migrantët e pritur ishin 78.484, nga të cilët 19.716 në Sistemin e Mbrojtjes për Azilkërkues e Refugjatë (Sprar) e pjesa tjetër në struktura të përkohshme ose të pritjes së parë.

129.887 qytetarë të huaj kanë marrë shtetësinë italiane në vitin 2014 (+29% në krahasim me 2013-n, kur prej kohësh regjistrohej një rritje të fuqishme në krahasim me vitin pararendës), ndërsa janë në ulje të lehtë martesat e përziera (18.273, d.m.th. 9,4% i 194.097 martesave të celebruara më 2013), të cilave u shtohen ato të lidhura midis të huajve (7.807, pra 3,8% i totalit).

Në vitin 2014 ka mbetur gati i qëndrueshëm numri i fëmijëve të lindur në Itali nga prindër që janë të dy të huaj (75.067 raste, 14,9% i totalit të të lindurve). Nga pothuajse 1 milion e 100 mijë të mitur të huaj, janë 814.187 të regjistruarit në shkollë në vitin shkollor 2014/2015, të rritur në një

vit me 11.343 vetë (rritja më e madhe u përket të lindurve në Itali: +8,4%), ndërsa vazhdojnë të ulen studentët italianë (8.886.076, -0,6%). Nxënësit e huaj me aftësi të kufizuar janë 26.626, d.m.th. 11,5% e totalit të nxënësve me aftësi të kufizuar.

Të punësuarit e huaj në vitin 2014 rezultuan 2.294.000 (1.238.000 meshkuj e 1.056.000 femra), më shumë se një e dhjeta e të gjithë të punësuarve (10,3%), me një përqindje punësimi sërish në rritje të lehtë. Qytetarët jo komunitarë me aftësi të kufizuar të regjistruar në listat provinciale të punësimit të detyrueshëm janë 13.108, pra 1,9% e totalit të të regjistruarve (e dhëna në datën 31 dhjetor 2013). Kriza ka bërë që efektet e saj t'i ndejnë edhe emigrantët dhe kanë qenë 154.686 (+6,2% në krahasim me 2013-n) lejeqëndrimet, shumica e të cilave janë lëshuar për arsye pune e familjare, që nuk janë ripërtërirë, me detyrimin pasues, për të interesuarit, që të ikin nga Italia. Qytetarët jo komunitarë që përfitojnë pensione për invaliditet, pension pleqërie e për të mbijetuarit janë 35.740 (baras me 0,2% të të gjithë përfituesve), ndërsa titullarët e pensioneve asistencialë janë 51.361 (1,4% e totalit).

Të ardhurat fiskale e të sigurimeve shoqërore që lidhen me punonjësit imigrantë kanë shkuar më 2013 në 16,6 miliardë euro, ndërsa shuma e daljeve të kryera për ta ka qenë 13,5 miliardë (saldo pozitive prej 3,1 miliardë eurosh). Nga ana tjetër, më 2013 kontributi ndaj PPB (Prodhimi i Brendshëm Bruto) prodhuar nga të punësuarit e huaj ka qenë 123.072 miliardë euro (baras me 8,8% të PBB kombëtar).

I rëndësishëm për t'u theksuar është edhe konstatimi se në periudhën 2004-2013 denoncimet penale me autorë të njohur kanë kaluar nga 692.000 në rreth 897.000, por ato ndaj italianëve, përballë një popullsie në ulje të lehtë, janë rritur nga 513.618 në 657.443 (+28,0%), ndërsa ato në ngarkim të të huajve, përballë një popullsie më shumë se të dyfishuar, janë ulur nga 255.304 në 239.701 (-6,2%).

Vazhdojnë rastet e diskriminimit mbi bazë etnike e racore: nga gjithsej 1.193 denoncime të mbledhura nga Unar gjatë vitit 2014, 990 prej tyre janë gjykuar relevante. Mass-mediat përfaqësojnë kuadrin me denduri më të madhe relative, me 291 raste, baras me 29,4% të totalit. Një e dhënë që thekson nevojën e informacionit korrekt e në vijimësi.

Disa pika kyçe ndihmojnë përmbledhjen e të dhënave të *Dossier Statistico Immigrazione 2015*: rritje progresive, ndonëse e ngadalësuar, e popullsisë imigrante; rritje e ndjeshme e proceseve të integritit (marrje të shtetësisë, regjistrime në shkollë, peshë specifike të të punësuarit e të lindjet); vazhdimi i bilancit pozitiv midis shpenzimeve publike dhe të ardhurave nga ana e të huajve; përmirësimi i statistikave penale; vështirësi në rritje për kapërcimin e diskriminimeve e në inkuadrimit e panoramës së ardhshme migratore.